

# **SHPLLJE PËR PRANIM TË DREJTPËRDREJTË, NË KATEGORINË E NIVELIT TË LARTË DREJTUES NË KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË**

Në zbatim të nenit 32, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 118, datë 05/03/2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, si dhe Urdhrit nr.147, datë 15.09.2021 të Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për “Hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në kategorinë e nivelit të lartë drejtues”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpall Procedurën e Pranimit të Drejtpërdrejtë në kategorinë e nivelit të lartë drejtues.

**1 (një) - Drejtor i Përgjithshëm – Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë - kategoria-II-a**

**Afati për dorëzimin e dokumenteve: 18 Tetor 2021**

## **Përshkrimi përgjithësues i punës**

1. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse ushtron veprimtari për ofrimin e shërbimeve mbështetëse duke përmbytur detyrat e mëposhtme:
2. Të mbikëqyrë punën e shërbimeve vartëse dhe të sigurojë ofrimin prej tyre të shërbimeve, sipas standardeve, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
3. Të koordinojë punën me drejtoritë e tjera në funksion të realizimit të detyrave me cilësi dhe në afat.
4. Menaxhon dhe ndjek nga afër të gjithë nevojat e kërkesat e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
5. Për këtë qëllim merr pjesë në hartimin e regjistrimit të parashikimit të prokurimeve publike të përvitshme dhe ndjek zbatimin e tij;
6. Të mbikëqyrë plotësimin e kushteve të nevojshme të punës për administratën dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tyre.
7. Në përbërje të komisionit të blerjeve me vlera të vogla, ndjek zbatimin e procedurave të prokurimit publik, realizimin e fondeve për blerjet me vlera të vogla, duke zbatuar procedurat ligjore për prokurimin publik dhe mban regjistrin përkatës.
8. Ndjek mirëmbajtjen e automjeteve të institucionit, për kryerjen e shërbimeve teknike dhe gatishmërinë teknike të tyre, si dhe për shpërndarjen e automjeteve.
9. Të sigurojë plotësimin e vendeve bosh në strukturë me cilësi, në kohë dhe konform ligjit “Për statusin e nëpunësit civil” dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, si dhe kërkesave të përcaktuara të vendit të punës.
10. Të sigurojë që të bëhet vlerësimi vjetor i punës së punonjësve të Shërbimit Mbështetës dhe të propozojë shpërblime në bazë të vlerësimit vjetor individual.
11. Kujdeset për përdorimin me efikasitet të teknologjisë së informacionit, të nivelit më të lartë të tij, në përdorimin e postës elektronike dhe përgjigjet për administrimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit kompjuterik të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
12. Të aprovojë grafikun e planifikuar për realizimin e pushimit vjetor të paguar, për shërbimet që varen nga ai.
13. Studion dhe propozon nevojat për fonde dhe merr pjesë në hartimin e planeve vjetore të shpenzimeve.

14. Të caktojë dhe të ndjekë grafikun e raportimit periodik (me shkrim ose me gojë) të shërbimeve në varësi.
15. Të kryejë çdo detyrë tjetër, në kuadrin e Shërbimit Mbështetës, që i ngarkohet nga Sekretari i Përgjithshëm ose instancat e tjera më të larta.

## **I - Kanë të drejtë të konkurrojnë për këto pozicione:**

1. Nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese, të cilët duhet të plotësojnë kriteret si vijon:

A - Të kenë të paktën 3 (tre) vite përvojë pune në pozicione të nivelit të mesëm drejtues ose të barasvlefshme me to (kategoria e pagës II-b);

B - Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master shkencor” ose të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;

2. Nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues në institucionet e pavarura, të cilët duhet të plotësojnë kriteret si vijon:

A - Të kenë të paktën 3 (tre) vite përvojë pune në pozicione të nivelit të mesëm drejtues ose të barasvlefshme me to (kategoria e pagës II-b);

B - Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master shkencor” ose të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;

3. Kandidatët nga jashtë shërbimit civil, të cilët duhet të plotësojnë kriteret minimale si vijon:

A - Të plotësojnë kushtet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, të përcaktuara në gërmat “a” deri në “dh” të nenin 21 të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar;

B - Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master shkencor” ose të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;

C - Të kenë të paktën 7 (shtatë) vjet përvojë pune nga të cilat 3 (tre) në pozicione të mesme drejtuese ose të barasvlefshme, në:

- institucione të administratës publike;
- institucionet bankare të nivelit të dytë dhe që, aktualisht, nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;
- shoqëri tregtare, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, konsiderohen si biznes i madh dhe që, aktualisht, nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;
- organizata jofitimprurëse, të cilat kanë, të paktën, 5 (pesë) vite që janë krijuar.

*Përrjashtimisht, kandidatët nga jashtë shërbimit civil, të cilët kanë punuar dhe/ose*

*punojnë:*

- në institucione ndërkombëtare brenda vendit;
- në profesion jashtë vendit;

*duhet të kenë, të paktën, 5 (pesë) vite përvojë pune, përkatësisht në këto institucione ose në profesion.*

Ç - Të mos kenë procese gjyqësore, civile, penale, administrative të cilat janë në proces, si edhe të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria.

## **II - Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

Të gjitha grupet e kandidatëve si më sipër duhet të dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:

- a.- Jetëshkrimin;
- b.- Fotokopje të diplomës;
- c.- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë përvojën në punë);
- ç.- Çdo dokumentacion që vërteton eksperiencën të tjera punësimit brenda ose jashtë vendit, të lëshuar nga punëdhënësi;
- d.- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Kandidatët nga jashtë shërbimit civil, përveç sa më sipër duhet të dorëzojnë dokumentacionin si vijon:

- a.- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- b.- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- c.- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- ç.- Vërtetimin nga institucionet bankare të nivelit të dytë apo shoqëritë tregtare të cilat sipas legjislacionit në fuqi konsiderohen si biznes i madh, në të cilat keni eksperiencë pune, që nuk kanë aktualisht detyrime ndaj shtetit, ose nuk janë në proces kundër tij.

Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentet e cituara më sipër me postë ose dorazi deri në datën 18 Tetor 2021, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Adresa; Rr. “Ana Komnena”, ish Fusha Aviacioni, Tiranë.

## **III - Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak**

Në datën 28 Tetor 2021, Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të shpallë në faqen e tij të internetit [www.klp.al](http://www.klp.al), në mjediset e tij dhe në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, nëpërmjet adresës së tyre të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

#### **IV - Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet konkurrimi**

Kandidatët pjesëmarrës në procedurë pas verifikimit paraprak nga ana e njësive përgjegjëse do të vlerësohen për:

##### **A. Njohuritë mbi:**

- a. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- b. Kompetencat e institucioneve të ndryshme dhe vendi që zenë ato në strukturën e përgjithshme qeveritare;
- c. Legjislacionin që rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes në sistemin e drejtësisë (ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, Ligj Nr. 96/2016 Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve);
- d. Legjislacionin mbi konfliktin e interesit dhe parandalimin e tij;
- e. Legjislacionin për nëpunësin civil (ligji nr. 152/2013, i ndryshuar dhe vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij);
- f. Kodin e Procedurave Administrative, legjislacionin që rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes në sistemin e drejtësisë (ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, Ligj Nr. 96/2016 Për Statusin E Gjyqtarëve Dhe Prokurorëve);
- g. Legjislacionin mbi konfliktin e interesit dhe parandalimin e tij;
- h. Legjislacionin për nëpunësin civil (ligji nr. 152/2013, i ndryshuar dhe vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij);
- i. Kodin e Procedurave Administrative

##### **B. Aftësitë për të:**

- a. Drejtuar dhe menaxhuar skuadrën;
- b. Menaxhuar situata emergjente;
- c. Marrë vendime mbi bazën e argumenteve;
- d. Shprehur opinionin dhe argumentet në mënyrë të rrjedhshme dhe të sjellshme;
- e. Komunikuar procesin e vendimmarrjes bazuar në argumente dhe analizë të pasojave;
- f. Ndërmarrë nisma të ndryshme strategjike dhe afatgjata brenda kompetencave të funksionit me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale, përmbushjen e objektivave dhe përcaktimin e rrugëve dhe hartimin e planeve për mënjanimin e risqeve në realizimin e tyre, duke shfrytëzuar kapacitetet njerëzore dhe materiale me kosto sa më të ulët dhe me rendiment maksimal;

## V - Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Konkurrimi i kandidatëve pjesëmarrës konsiston në:

- 1 - Vlerësimin e jetëshkrimit, që përfshin vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 10 pikë.
- 2 - Testimin me shkrim. Totali i pikëve është 40 pikë.
- 3 - Intervistën e strukturuar me gojë. Totali i pikëve është 50 pikë.

Testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë synojnë vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive të lidhura me fushën sipas përcaktimit në pikën IV të kësaj shpalljeje.

## VI - Data e zhvillimit të konkurrimit

Testimi me shkrim do të zhvillohet në datën **16 Nëntor 2021**, në orën **11:00**, në mjediset e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Adresa; Rr. “Ana Komnena”, ish Fusha Aviacioni, Tiranë.

Pas zhvillimit të testimit me shkrim kandidatët do të njoftohen nëpërmjet adresës së tyre elektronike, në lidhje me datën dhe orën e zhvillimit të intervistës së strukturuar me gojë.

## VII - Data e shpalljes së rezultateve për vlerësimin përfundimtar

Lista e fituesve e përbërë nga kandidatët që kanë grumbulluar mbi 70 pikë, të renditur duke filluar nga ai me më shumë pikë dhe brenda numrit të pozicioneve për të cilat konkurrohet, do të shpallet në faqen e zyrtare të “Këshillit të Lartë të Prokurorisë” [www.klp.al](http://www.klp.al), mjediset e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në datën **21 Nëntor 2021**.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk janë shpallur fitues do të njoftohen nga KLP nëpërmjet adresës së tyre të e-mail.